



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:070067
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05513656

2022:070068

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Idrizi, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve N.A. me numër personal ... dhe N.R. me numër personal ..., të cilët me autorizim i përfaqëson e autorizuar Marigona Gashi avokate në Lipjan, kundër të paditurës Komuna e Shtimes – DKA, të cilën me autorizim e përfaqëson i autorizuari L.M., për shkak të shpërblimit të inflacionit në pagë, vlera e kontestit 1.642,74 euro, jashtë seance me datë 27.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësve N.A. me numër personal ... dhe N.R. me numër personal
- II. Detyrohet e paditura që paditësve N.A. në emër të shpërblimit të inflacionit në pagë për periudhën 04.04.2019-21.11.2022 të ja paguajë shumën në vlerë prej 821,35€ (tetëqind e njëzetë e një euro e tridhjetë e pesë cent), dhe N.R. në emër të shpërblimit të inflacionit në pagë për periudhën 04.04.2019-21.11.2022 të ja paguajë shumën në vlerë prej 821,35€ (tetëqind e njëzetë e një euro e tridhjetë e pesë cent), me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data 07.04.2022 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.
- III. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesa për kompensimin e shpenzimeve të procedurës ashtu që detyrohet e paditura Komuna e Shtimes - DKA, që paditësve N.A. dhe N.R. në emër të shpenzimeve të procedurës, të ja paguaj shumën prej 196.00€ në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm ndërsa refuzohet si e pabazuar kërkesa për kompensimin e parashtrësës për precizim të padisë në shumë prej 156,00€ si e pabazuar.

A r s y e t i m

Paditësit N.A. dhe N.R. në këtë gjykatë me datë 07.04.2022, përmes të autorizuarit të tyre Marigona I. Gashi avokate në Lipjan kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Shtimes–DKA, për kompensimin e inflacionit në pagë, duke theksuar se paditësit janë në marrëdhënie

pune me të paditurën dhe atë: paditësi N.A. është e sistemuar në shkollën fillore të mesme të ulët ‘H.P.’ në fshatin ... Komuna Shtime, dhe paditësi N.R. është i sistemuar në shkollën ‘H.P.’ në fshatin ... Komuna Shtime.

E autorizuar e paditësve përmes parashtresës për precizimin e kërkesëpadisë së dt. 06.12.2023 ka theksuar që të punësuarve iu takon kompensimi për inflacion gjegjësisht për paditësen N.A. në emër të inflacionit për periudhën nga dt. 04.04.2019 deri më 21.11.2022 shuma prej 821.35 euro, Ndërsa për paditësin N.R. në emër të inflacionit për periudhën nga dt. 04.04.2019 deri më 21.11.2022 shuma prej 821.35 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore 8%, dhe shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, përkatësisht 156 euro për padi, 156 euro për precizim të padisë dhe taksën gjyqësore për padi.

E paditura Komuna e Shtimës, përmes të autorizuarit të saj L.M. në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 03.11.2023, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se kërkesa është tërësisht e papranueshme pasi që padia është e mbështetur në kontratën kolektive të vitit 2017 e cila më nuk është në fuqi, dhe e ka kundërshtuar kërkesën duke theksuar se kjo kërkesë është parashkruar, në lidhje me inflacionin ka theksuar se është kompetencë e nivelit qendror dhe nuk llogaritet në asnjë kategori të të punësuarve dhe kjo nuk mund të paraqitet vetëm për punëtorët e arsimit pasi që do të paraqiste diskriminim.

Gjykata për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë çështje juridiko-civile zhvilloi procedurën e provave sipas propozimit të palëve në procedurë dhe atë: Kontratë pune e lidhur në mes paditësit N.R. dhe të paditurës e dt. 12.01.2018, Kontratë pune e lidhur në mes paditësit N.A. dhe të paditurës e dt. 26.01.2016, lista e pagave për muajin janar 2019 për të dy paditësit.

Nga kontrata së punës për paditësin N.R. me numër të prot. ... datës 12.01.2018, e lëshuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Shtime vërtetohet se paditësi me të paditurën ka lidhur kontratë pune për pozitën arsimtar i lëndës së historisë në SHFMU "H.P." në fshatin ... Komuna Shtime, me pagë bazë 421,00€.

Nga kontrata e punës për paditësen N.A. me numër të prot. ... e datës 26.01.2016, e lëshuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Shtime vërtetohet se paditësi me të paditurën ka lidhur kontratë pune për pozitën mësuese klase në SHFMU "H.P." në fshatin ... Komuna Shtime, me pagë bazë prej 421€.

Përmes listës së pagave të muajit janar 2019 u vërtetua se paditësit kanë pagën bazë 421,00, neto.

Vërtetimin si dhe kontratën e lartcekur, gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së në të cilin përcaktohet se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë

besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj.

Gjykata, pas administrimit të provave, ka bërë shqyrtimin e tyre veç e veç si dhe të ndërlidhura si tërësi mes veti, mbi bazën e bindjes së saj të lirë në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar.

Gjykata përmes kontratës së punës, ka vërtetuar faktin e ekzistimit të marrëdhënies së punës e cila nuk ka qenë kontestuese as nga e paditura, kurse përmes listave të pagës ka vërtetuar faktin se paditësit në periudhën kontestuese kanë qenë në marrëdhënie pune të vazhdueshme tek e paditura.

Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”. Andaj gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë (për të dy paditësit):

- Për periudhën prill – dhjetor 2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2019 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 102.3 euro,
- Për periudhën janar – dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 10.10 euro,
- Për periudhën janar – dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171.76€ dhe

- Për periudhën janar – nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 537.19€.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigje në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor, e po ashtu i pabazuar mbetet edhe pretendimi i të paditurës se kërkesa e paditësit është përfshirë në parashkrim, pasi që gjykata vlerëson se paditësi e ka paraqitur kërkesën e tij në afat (datë 07.04.2022).

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452, 453.2 dhe 463 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 156 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 40 euro, totali 196,00€. Kërkesa për kompensimin e parashtresës për precizim të kërkesëpadisë u refuzua pasi për këtë lloj kërkesë nuk parashihet kompensimi.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 143 të LPK.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Datë 27.03.2024

Gjyqtari
Armend Ahmeti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.